



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**Rregulla ZRRE/Nr. 03/2017**

**Rregulla për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të operatorit të  
sistemit të transmetimit dhe tregut  
(Rregulla për Të Hyrat e OST/OT-së)**

16 Mars 2017

## PËRMBAJTJA

KREU I	KUSHTET E PËRGJITHSHME	4
Neni 1	Qëllimi dhe fushëveprimi	4
Neni 2	Përkufizimet dhe interpretimet	4
Kreu II	RREGULLIMI I TË HYRAVE TË OST/OT	10
Neni 3	Parimet e përgjithshme	10
Neni 4	Shqyrtimet e vlerave hyrëse	10
Neni 5	Shqyrtimet periodike dhe periudhat rregullative	10
Neni 6	Përshtatjet e rregullta	11
Neni 7	Shqyrtimet e jashtëzakonshme	12
KREU III	TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE	13
Neni 8	Parimet themelore	13
Neni 9	Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes	14
Neni 10	Zhvlerësimi i lejuar	14
Neni 11	Kthimi i lejuar në kapital	15
Neni 12	Kostot e lejuara për shërbime ndihmëse	15
Neni 13	Kostot e lejuara të humbjeve	15
Neni 14	Kostot e taksës së licencës	17
Neni 15	Kostot e përjashtuara	17
Neni 16	Zbutja e të hyrave të lejuara	17
KREU IV	TARIFAT PËR SHFRYTËZIM TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT	19
Neni 17	Parimet e përgjithshme	19
Neni 18	Procedura për aprovimin e tarifave për SHST	19
KREU V	TARIFAT PËR OPERATOR TË SISTEMIT	20
Neni 19	Parimet e përgjithshme	20
Neni 20	Procedura për aprovimin e tarifave për operatorin e sistemit	20
KREU VI	TARIFAT PËR OPERATOR TË TREGUT	21
Neni 21	Parimet e përgjithshme	21
Neni 22	Procedura për aprovimin e tarifave për operatorin e tregut	21
Neni 23	Tarifa për fondin e energjisë së ripërtitshme	21
KREU VII	TAKSAT PËR KYÇJE	22
Neni 24	Parimet e përgjithshme	22
Neni 25	Procedura për aprovimin e taksave për kyçje	22
KREU VIII	TARIFAT PËR FONDIN E ENERGJISË SË RIPËRTËRITSHME	24
Neni 26	Parimet e përgjithshme	24
KAPITULLI IX	DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE	25

Neni 27 Interpretimi	25
Neni 28 Ndryshimi	25
Neni 29 Shfuqizimi	25
Neni 30 Hyrja në fuqi	25
SHTOJCA 1 LLOGARITJA E TË HYRAVE TË LEJUARA MAKSIMALE	26
SHTOJCA 2 VLERAT HYRËSE	32
SHTOJCA 3 BAZA E ASETIVE TË RREGULLUARA	33
SHTOJCA 4 MESATARJA E PONDERUAR E KOSTOS SË KAPITALIT	36
SHTOJCA 5 SHËRBIMET E PËRJASHTUARA	38
SHTOJCA 6 PROCESI I SHQYRTIMIT PERIODIK	40
SHTOJCA 7 PROCESI I PËRSHTATJEVE TË RREGULLTA	43
SHTOJCA 8 PROCESI I SHQYRTIMIT TË JASHTËZAKONSHËM	44
SHTOJCA 9 NGJARJET E JASHTËZAKONSHME	46
SHTOJCA 10 NGJARJA E FORCËS MADHORE	47
SHTOJCA 11 DISPOZITAT KALIMTARE	48

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, sipas autoritetit të dhënë në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-84, respektivisht në nenin 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, nenin 15, paragrafin 1, nënparagrafi 1.5, nenin 26, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, nënparagrafi 1.2 dhe nenin 47, paragrafi 1, në seancën e mbajtur me 16.03.2017, miratoi:

## Rregulla për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të operatorit të sistemit të transmetimit dhe tregut (Rregulla për Të Hyrat e OST/OT-së)

### KREU I                      KUSHTET E PËRGJITHSHME

#### Neni 1

#### Qëllimi dhe fushëveprimi

- 1        Kjo rregull përcakton:
  - 1.1      Bazën për vlerësimin e të hyrave të lejuara maksimale që Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) mund të përfitojë në një vit relevant, në mënyrë që OST të mbulojë kostot e arsyeshme të zhvillimit, operimit dhe mirëmbajtjes së sistemit të transmetimit në mënyrë që ai të vihet në dispozicion të shfrytëzuesëve të sistemit në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë;
  - 1.2      Bazën sipas së cilës vendoset për të hyrat maksimale të lejuara që mund të fitohen nga operatori i tregut ("OT") brenda çdo viti relevant në mënyrë që OT të mbulojë kostot e arsyeshme të operimit dhe të menaxhimit së tregut të energjisë elektrike, në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë;
  - 1.3      Procesin sipas të cilit të hyrat e lejuara maksimale do të shqyrtohen dhe do të ripërcaktohen periodikisht dhe azhurnimet e rregullta vjetore; dhe
  - 1.4      Procesin sipas të cilit përcaktohen taksat për kyçje dhe tarifat për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit (SHST), tarifat e operatorit të sistemit (OS) dhe tarifat e operatorit të tregut (OT), prej të cilave do të mblidhen të hyrat e lejuara maksimale.

#### Neni 2

#### Përkufizimet dhe interpretimet

- 1        Shprehjet e përdorura në këtë rregull kanë këtë kuptim:
  - 1.1      **Të hyra të rregulluara aktuale** - të hyrat e mbuluara nga OST/OT përmes tarifave për kryerjen e shërbimeve të sistemit të transmetimit dhe operatorit të tregut, si dhe të gjitha të hyrat e tjera të përcaktuara nga rregullatori e të matura në baza të rrjedhës aktuale;

- 1.2 **Shërbimet ndihmëse** - të gjitha shërbimet e nevojshme për operimin e sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes;
- 1.3 **Plan i aprovuar i investimit** - programin e projekteve kapitale për periudhën rregulative që aprohet nga ZRRE në kuadër të shqyrtimit periodik;
- 1.4 **Ditë pune** - të gjitha ditët e punës brenda një jave, siç përkufizohen me ligjet në Kosovë;
- 1.5 **Kyçja e shfrytëzuesve në rrjetin e transmetimit** - krijimi i kushteve teknike për kyçje, sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj dhe legjislacionit në fuqi që rregullojnë sektorin e energjisë elektrike;
- 1.6 **Taksë për kyçje**- taksa që aplikohet nga OST për kyçjen e konsumatorëve në sistemin e transmetimit;
- 1.7 **Jetëgjatësia Ekonomike** - shpërndarja sistematike e shumës së zhvlerësueshme të një asemi gjatë jetës së tij të dobishme të lejuar nga baza e aseteve të rregulluara;
- 1.8 **Faktori i efikasitetit** - caku i reduktimit të kostove i përcaktuar gjatë shqyrtimeve periodike dhe që aplikohet gjatë përshtatjeve të rregullta për të përcaktuar kostot e lejuara të operimit dhe të mirëmbajtjes për OST/OT;
- 1.9 **EURIBOR** - norma e ofrimit për depozita të euros nga Federata bankare evropiane për periudhë 12-mujore, që paraqitet në faqen e caktuar të shërbimit të “Reuters” në ora 11:00 (kohë e matur sipas kohës qendrore evropiane) ose, në rast se “Reuters” nuk vazhdon ta ofrojë këtë shërbim, cilido shërbim tjetër të cilin Rregullatori e konsideron si të besueshëm;
- 1.10 **Shërbimet e Përrjashtuara** - shërbimet e ofruara nga OST/OT në kuadër të aktiviteteve të tij të licencuara, kostot e të cilave përjashtohen nga të hyrat e lejuara maksimale dhe të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen me, kryerjen e kyçjeve në sistemin e transmetimit, transitin apo ofrimin e shërbimeve sipas kërkesës së palëve të treta specifike;
- 1.11 **Ngjarje e Jashtëzakonshme**- ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 9;
- 1.12 **Shqyrtim i Jashtëzakonshëm** - ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 8;
- 1.13 **Forcë Madhore**- ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 10;
- 1.14 **Taksa për licencë** - shuma për pagesë sipas pasqyrës së taksave, që lëshohet nga rregullatori;
- 1.15 **Humbjet e lejuara**- ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 13;
- 1.16 **Faktori i ndarjes së humbjeve**- ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 13;
- 1.17 **Faktori i ndarjes së kursimeve**- ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 2;

- 1.18 **Operatori i Tregut (OT)** - person fizik ose juridik, i licencuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji dhe është përgjegjës për të operuar dhe organizuar tregun e energjisë elektrike në Kosovë;
- 1.19 **Operimi i tregut** - veprimtaria që kryen operatori i tregut lidhur me menaxhimin e tregut të energjisë elektrike dhe përgatitjen e raporteve financiare për pjesëmarrësit e tregut, pa përfshirë blerjen apo shitjen e energjisë elektrike, në përputhje me parashikimet e rregullave të tregut;
- 1.20 **Tarifat për operatorin e tregut** - Tarifat për detyrimet që paguhen për operimin dhe organizimin e tregut të energjisë elektrike që përcaktohen nga Rregullatori sipas Metodologjisë tarifore për operim të tregut të energjisë elektrike;
- 1.21 **Ndërmarrje e energjisë elektrike** - personi fizik apo juridik që kryen një apo më shumë veprimtari të licencuara të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, furnizimit, tregtimit, tregut të organizuar të energjisë elektrike dhe është përgjegjës për detyrat komerciale, teknike ose të mirëmbajtjes që ndërlidhen me veprimtaritë e cekura, por nuk përfshinë konsumatorin final;
- 1.22 **Pragu i materialitetit**- ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 8;
- 1.23 **Të hyrat e lejuara maksimale ose MAR** - të hyrat maksimale siç përcaktohet në Shtojcën 1 të kësaj rregulle, që mund të mbulohen brenda një viti relevant nga OST/OT përmes tarifave të OST/OT-së;
- 1.24 **Kërkesa maksimale e sistemit të transmetimit** - kërkesa maksimale e energjisë elektrike brenda një viti (në MW) të matur në pikat hyrëse të sistemit të transmetimit të OST-së;
- 1.25 **E matur** - çdo sasi e matur e energjisë elektrike, duke përfshirë këtu matjet për energjinë aktive, energjinë reaktive dhe fuqinë, në pajtim me matësin e instaluar sipas kodit të matjes;
- 1.26 **Vlera Neto e Tanishme** - shuma e zhvlerësimit të rrjedhave të ardhshme të parasë;
- 1.27 **Shfrytëzimi i sistemit të rrjetit** – shfrytëzimi i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike nga pika hyrëse në sistem deri te pikat e furnizimit të konsumatorëve;
- 1.28 **Faktori Profilizues** - faktori i përcaktuar në shqyrtimet periodike dhe që aplikohet në kostot e lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes, zhvlerësimit dhe kthimit në kapital siç përcaktohet në Nenin 16.
- 1.29 **Vlerësim i Përkohshëm**- ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 6, paragrafi 10;
- 1.30 **Furnizues** - ndërmarrje e energjisë e licencuar për të kryer veprimtarinë e furnizimit;
- 1.31 **Furnizim** - shitjen, përfshirë rishitjen e energjisë elektrike te konsumatorët;

- 1.32 **Shqyrtimi periodik** - shqyrtimi nga Rregullatori i të hyrave të lejuara maksimale të OST/OT-së për periudhën e ardhshme rregullative;
- 1.33 **Përshtatje e rregullt** - përshtatja e të hyrave të lejuara maksimale që bëhet në fund të çdo viti relevant tarifor;
- 1.34 **Njësitë e rregulluara të faturuara** - sasia totale e njërive të energjisë elektrike që u faturohet konsumatorëve që furnizohen nga sistemi i transmetimit;
- 1.35 **Njësitë e rregulluara të transmetuara** - sasia totale të energjisë elektrike të transmetuar përmes sistemit të transmetimit për konsumatorët brenda një viti relevant, të matur në pikat dalëse të sistemit të transmetimit (ose, në rastet kur nuk ka matës, siç llogariten në pajtim me praktikat e njohura inxhinierike);
- 1.36 **Zyra e Rregullatorit për Energji** - (në tekstin e mëtejshëm: Rregullatori) – është agjenci e pavarur në sektorin e energjisë, e themeluar me ligjin për Rregullatorin e Energjisë;
- 1.37 **Baza e asetëve të rregulluara** - të gjitha asetet e përdorura dhe të dobishme në ofrimin e shërbimeve nga subjekti i rregulluar, përveç asetëve plotësisht të zhvleftësuar;
- 1.38 **Periudhë rregullative**- ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 5;
- 1.39 **Vit Relevant** - periudha prej 12 muajsh të njëpasnjëshëm në mes të përshtatjeve të rregullta;
- 1.40 **Tarifa nxitëse** - është mekanizëm mbështetës i bazuar në çmim që është shfrytëzuar për promovimin e BRE-ve. Ajo garanton shitjen e energjisë nga prodhuesit e BRE-ve me prioritet të pranuar në skemën mbështetëse, sipas një çmimi të caktuar për një periudhë të caktuar kohore;
- 1.41 **Burim e ripërtërishme të energjisë ose BRE** - burimi i ripërtërishëm, jofosil të energjisë si: energjia e erës, energjia diellit, energjia gjeotermale, energjia e ujit, energjia e valëve, biomasa, gaz i mbetjeve urbane, gaz i mbetjeve të trajtimit të ujërave dhe biogazi; siç është përcaktuar në legjislacionin në fuqi për burimet e energjisë së ripërtërishme;
- 1.42 **Certifikata e Originës** - një dokument të formës elektronike, që lëshohet nga Zyra e Rregullatorit për Energji, që ka funksionin e shitjes, me qëllim të ofrimit si provë të konsumatori fundor së një pjesë e caktuar e energjisë është prodhuar nga burime të energjisë së ripërtërishme;
- 1.43 **Skema Mbështetëse** - stimujt financiar nga të cilat ofrohet nxitje për prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtërishme për të tërhequr kapacitete të mjaftueshme për të arritur cakun për BRE-të;
- 1.44 **Fondi për Energjinë e Ripërtërishme ose FER**- fondi i krijuar dhe të menaxhuar nga operatori i tregut në përputhje me rregullën për skemën mbështetëse. FER do të rikthejë kostot shtesë të blerjes së prodhimit të BRE-ve të pranuar në skemën mbështetëse (dallimi ndërmjet tarifave nxitëse ekzistuese dhe çmimit të tregut), kostot

e lejuara të imbalancit të ndërlidhura me prodhimin nga BRE-të dhe kostot shtesë të shkaktuara nga Operatori i Tregut në menaxhimin dhe operimin e FER-it;

- 1.45 **Tarifa për Energjinë e Ripërtrishme** - tarifë të veçantë në nivel të transmetimit e cila mbulon kostot e Fondit për Energjinë e Ripërtrishme për të cilën është lëshuar certifikata e origjinës, e cila mund të azhurnohet gjatë shqyrtimeve të rregullta vjetore. Kjo tarifë është proporcioni i kostove totale të operimit të Fondit për energjinë e ripërtrishme ndaj konsumit të parashikuar të energjisë që do të ngarkohet nga operatori i tregut;
- 1.46 **Parimet për përcaktimin e tarifave për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit dhe taksave për kyçje**- parimet e lëshuara nga rregullatori me të cilën duhet të jenë në pajtueshmëri metodologjitë e OST/OT-së për përcaktimin e tarifave dhe taksave për kyçje;
- 1.47 **Raport mbi ndikimin financiar**- ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 8;
- 1.48 **Tarifat e operatorit të sistemit apo Tarifat e OS**- tarifat që aplikohen nga OS për ofrimin e shërbimeve të operatorit të sistemit;
- 1.49 **Shërbimet e operimit të sistemit**- shërbimet të cilat i licencuari për OST është i autorizuar t'i ofrojë sipas kushteve të licencës për operim të sistemit të dhënë nga rregullatori.
- 1.50 **Tarifat e SHST** - tarifat që aplikohen nga OST për ofrimin e shërbimeve për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit;
- 1.51 **Humbjet në transmetim**- totali i energjisë së humbur në sistemin e transmetimit që operohet nga OST dhe përbëhen nga;
- (a) humbjet teknike siç përcaktohen nga vlerësimet inxhinierike, dhe;
- (b) humbjet komerciale që përkufizohen si energjia që hyn në sistemin e transmetimit minus humbjet teknike minus energjia që u faturohet konsumatorëve fundor.
- 1.52 **Operatori i Sistemit të Transmetimit** ose "OST"- personi fizik, ose juridik përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe, sipas nevojës, zhvillimin e rrjetit të transmetimit në një zonë të caktuar përfshirë kurdo që kjo është e mundur, interkonektorët me sistemet tjera, dhe për të garantuar aftësinë afatgjate të rrjetit për të përmbushur kërkesat për transmetimin e energjisë elektrike;
- 1.53 **Shërbimet e sistemit të transmetimit**- shërbimet të cilat i licencuari për OST është i autorizuar t'i ofrojë sipas kushteve të licencës për operim të sistemit të dhënë nga rregullatori, duke përfshirë shërbimet e operatorit të sistemit dhe shërbimet e shfrytëzimit të sistemit. Operatori i Sistemit të Transmetimit siguron shërbimet e sistemit në përputhje me parimet e tregut dhe të kontratave për ofrimin e shërbimeve. Shfrytëzimi i shërbimeve të ofruara nga ofruesi i shërbimeve ndihmëse dhe shërbimeve balancuese mund të bëhet me kërkesë të Operatorit të Sistemit të Transmetimit;



- 1.54 **Sistemi i Transmetimit** - sistemi i përbërë nga kombinimi i linjave, nënstacioneve dhe stabilimenteve të tensionit të lartë që shërbejnë për transmetimin e energjisë elektrike;
  - 1.55 **Balancimi** - është tërësia e proceseve, nëpërmjet të cilave Operatori i Sistemit të Transmetimit operon dhe ruan frekuencën e sistemit brenda kufijve të përcaktuar të qëndrueshmërisë së tij;
  - 1.56 **Njësi e energjisë së transmetuar**- nënkupton një MWh;
  - 1.57 **Mesatare e Ponderuar e Kostos së Kapitalit** - ka kuptimin që i është dhënë në Shtojcën 4;
  - 1.58 **Çmimet referente të tregut të energjisë elektrike** - është çmimi mesatar i energjisë elektrike të tregtuara në tregje të energjisë në mënyra të ndryshme dhe periudha të ndryshme;
  - 1.59 **Kongjestion** – situatatën kur një interkoneksion që lidh sistemet shtetërore të transmetimit nuk mund të përballojë të gjitha rrjedhat fizike të energjisë që rezultojnë nga tregtimet ndërkufitare të kërkuara nga pjesëmarrësit në treg, për shkak të mungesës së kapacitetit interkonektiv dhe/ose shtetëror të sistemeve transmetuese në fjalë;
  - 1.60 **Grant Kapital** - mbështetja financiare, apo forma tjera të mbështetjes pa kthim të investimeve;
- 2 Termat e tjera të kësaj rregulle do ta kenë kuptimin që u është dhënë në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë Elektrike apo në Ligjin për Energjinë.

**Neni 3****Parimet e përgjithshme**

1. OST/OT do të propozojë tarifat për shfrytëzim të rrjetit të transmetimit (SHST) (Kreu IV), tarifat e operatorit të sistemit (OS) (Kreu V) dhe tarifat e operatorit të tregut (OT) (Kreu VI), ashtu që brenda çdo viti relevant, të hyrat që priten të mbledhë nga këto tarifa do të jenë të barabarta me të hyrat e lejuara maksimale (Kreu III) të aprovuara nga rregullatori.
2. Të hyrat e lejuara maksimale do të përcaktohen si vijon:
  - 2.1 Të hyrat e lejuara maksimale do të caktohen në shqyrtimet periodike (Neni 5);
  - 2.2 Para përfundimit të çdo viti relevant do të aplikohet një përshtatje e rregullt (Neni 6) që përfshin përshtatjet e të hyrave të lejuara maksimale për të marrë parasysh ndryshimet e arsyetuara të kostove, përfshirë edhe kostot që janë jashtë kontrollit të OST/OT-së; dhe
  - 2.3 Shqyrtimet e jashtëzakonshme (Neni 7), që përfshijnë përshtatjet në të hyrat e lejuara maksimale si rezultat i ndryshimeve materiale të kostove të shkaktuara nga një ngjarje e jashtëzakonshme.

**Neni 4****Shqyrtimet e vlerave hyrëse**

1. Vlerat hyrëse përcaktohen gjatë shqyrtimeve periodike, këto vlera përdoren për llogaritjen e të hyrave të lejuara maksimale të OST/OT-së.
2. Shqyrtimet e vlerave hyrëse do të iniciohen nga rregullatori kurdo që rrethanat e ndryshuara kërkojnë iniciimin e një shqyrtimi të tillë. Ndryshimet në vlerat hyrëse duhet të bëhen vetëm në atë masë që këto ndryshime të jenë të arsyeshme, të justifikuar dhe të caktuara me kujdes.
3. OST/OT mund t'i propozojë rregullatorit shqyrtimit të vlerave hyrëse. Rregullatori do t'i përgjigjet kërkesës së tillë me një shkresë që paraqet arsyetimet për vendimin e ZRRE-së për të filluar apo për të mos filluar shqyrtimin.
4. Procedura për mbarëvajtjen e shqyrtimeve të vlerave hyrëse është dhënë në Shtojcën 2.

**Neni 5****Shqyrtimet periodike dhe periudhat rregullative**

1. Të hyrat e lejuara maksimale për OST/OT-në për periudhën rregullative do të caktohen gjatë shqyrtimeve periodike.
2. Shqyrtimet periodike do të iniciohen para çdo periudhe rregullative.

3. Secila periudhë rregullative do të jetë 5-vjeçare, përveç:
  - 3.1 Në rast të pajtimit reciprok në mes të OST/OT-së dhe rregullatorit, periudha periodike mund të shkurtohet apo të zgjatet.
4. Formulatat për llogaritjen e të hyrave të lejuara maksimale për shqyrtimet periodike janë të dhëna në Shtojcën 1.
5. Procesi për kryerjen e shqyrtimeve periodike është dhënë në Shtojcën 6.

## **Neni 6**

### **Përshtatjet e rregullta**

- 1 Gjatë përshtatjeve të rregullta do të llogariten ndryshimet e lejuara të të hyrave të lejuara maksimale.
- 2 Përshtatjet e rregullta do të bëhen para çdo viti të ardhshëm relevant.
- 3 Ndryshimi i të hyrave të lejuara maksimale gjatë çdo përshtatjeje të rregullt duhet të llogaritet duke u bazuar në:
  - 3.1 Indeksimin e kostove të lejuara të operimit dhe të mirëmbajtjes për të marrë parasysh përmirësimet e pritura përmes faktorit të efikasitetit;
  - 3.2 Indeksimin e kostove të lejuara të operimit dhe të mirëmbajtjes (pas aplikimit të faktorit të efikasitetit), zhvlerësimin e lejuar dhe kthimin e lejuar në kapital me inflacionin;
  - 3.3 Azhurnimi i parashikimit për kostot e lejuara të shërbimeve ndihmëse dhe kostot e lejuara të humbjeve, si dhe të taksës së licencës;
  - 3.4 Nën-mbulimin apo mbi-mbulimin e kostove të lejuara të humbjeve në vitin e tanishëm relevant (i përfunduar tashmë), që mund të vijë si pasojë e ndryshimeve të volumeve të parashikuara dhe të realizuara të energjisë elektrike të transmetuar dhe çmimeve referente të tregut të energjisë elektrike, subjekt i ndarjes së nën apo mbi mbulimit të tillë në mes të OST-së dhe të shfrytëzuesve të sistemit të transmetimit;
  - 3.5 Nën-mbulimin apo mbi-mbulimin e të hyrave të lejuara maksimale gjatë vitit relevant të tanishëm, për shkak të ndryshimeve në mes të transmetimit të parashikuar dhe aktual të energjisë elektrike në rrjetin e tij dhe/ose ndryshimeve në mes të kërkesës maksimale të parashikuar dhe asaj të realizuar; dhe
  - 3.6 Nën-mbulimin apo mbi-mbulimin e kostove të lejuara të humbjeve në veri gjatë vitit relevant tarifor, për shkak të diferencave në mes të transmetimit të parashikuar dhe aktual të energjisë elektrike në rrjetin e tij dhe ndryshimeve të çmimeve referente të tregut të energjisë elektrike.
4. Kurdo që rregullatori vëren (vlerëson) se i licencuari nuk ka realizuar kostot me qëllim të kursimit dhe rritjes së profitit (në veçanti shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes) duke mos përmirësuar kualitetin e shërbimit dhe performancën në nivelin e kërkuar sipas standarteve.

Rregullatori mund të bëjë përshtatjet e këtyre kostove gjatë përcaktimit të të hyrave të lejuara maksimale gjatë përshtatjeve të rregullta apo në periudhën e ardhshme rregullative.

5. Në rastin kur i licencuari arrin të realizojë të njëjtat objektiva (të kualitetit të shërbimit dhe përfomancës) me kosto më të ulta si rezultat i efikasitetit dhe përfomancës së tij, rregullatori mund të lejojë që i licencuari të mbaj ndryshimin e këtyre kostove si nxitje në përmirësimin e përfomancës. Nxitjet për kursimet e tilla bëhen duke aplikuar faktorin ndarës të kursimeve.
6. Në rastin e tejkalimeve e shpenzimeve mbi nivelin e lejuar, ndryshimi i kostove të tilla do të jetë barrë e OSTOT, përveç shpenzimeve të cilat janë jashtë kontrollit të saj.
7. Në rastin kur ka ndryshime ndërmjet investimeve kapitale të lejuara dhe realizuara gjatë cilitdo vit relevant, rregullatori mund të bëjë përshtatjet e kostove të zhvlerësimit dhe kthimit të cilat derivohen nga investimet kapitale. Përshtatjet e këtyre kostove mund të bëhen gjatë procesit të përshtatjeve të rregullta apo në periudhën e ardhshme rregullative.
7. Formulat për llogaritjen e të hyrave të lejuara maksimale gjatë përshtatjeve të rregullta janë dhënë në Shtojcën 1.
8. Procesi për kryerjen e përshtatjeve të rregullta është dhënë në Shtojcën 7.

## **Neni 7**

### **Shqyrtimet e jashtëzakonshme**

1. Shqyrtimet e jashtëzakonshme mund të shkaktohen nga ngjarjet e jashtëzakonshme, siç përkufizohen në Shtojcën 9.
2. Gjatë shqyrtimeve të jashtëzakonshme do të llogaritet ndikimi i ngjarjes së jashtëzakonshme në të hyrat e lejuara maksimale për pjesën e mbetur të periudhës rregullative. Nëse ndikimi është më i lartë se pragu i materialitetit, atëherë do të bëhet përshtatja në të hyrat e lejuara maksimale. Pragu i materialitetit do të jetë 5% e të hyrave, përveç në rastet kur vendoset ndryshe në shqyrtimet periodike në marrëveshje të përbashkët në mes të OST/OT-së dhe rregullatorit.
3. Llogaritja e ndikimit në të hyrat maksimale të lejuara dhe e përshtatjes së jashtëzakonshme nuk duhet të marrë parasysh faktorët të cilët nuk ndikohen drejtpërsëdrejti nga ngjarja e jashtëzakonshme.
4. Rregullatori do të marrë parasysh ndikimet e vazhdueshme të ngjarjeve të jashtëzakonshme (që e kalojnë pragun e materialitetit) në shqyrtimet e ardhshme periodike.
5. Procesi për realizimin e shqyrtimeve të jashtëzakonshme është dhënë në Shtojcën 8.

## Neni 8

## Parimet themelore

- 1 Të hyrat e lejuara maksimale do të caktohen në atë nivel që t'i mundësojnë OST/OT-së mbulimin e kostove të arsyeshme për ofrimin e shërbimeve të sistemit të transmetimit dhe operimit të Tregut, deri në masën që këto kosto të jenë të justifikuara dhe të vlerësuara me kujdes.
- 2 Kostot e arsyeshme të OST/OT-së përfshijnë:
  - 2.1 Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes (Neni 9), të cilat do të përshtaten për të marrë parasysh inflacionin dhe faktorin e efikasitetit gjatë përshtatjeve të rregullta;
  - 2.2 Zhvlerësimin e lejuar (Neni 10), i cili do të përshtatet për të reflektuar inflacionin gjatë përshtatjeve të rregullta;
  - 2.3 Kthimin e lejuar në kapital (Neni 11), i cili do të përshtatet për të reflektuar inflacionin gjatë përshtatjeve të rregullta;
  - 2.4 Kostot e lejuara për shërbimet ndihmëse (Neni 12), të cilat do të barten në mënyrë të plotë gjatë përshtatjeve të rregullta;
  - 2.5 Kostot e lejuara të humbjeve (Neni 13), të cilat do të bazohen në nivelin e lejuar të humbjeve dhe do të barten gjatë përshtatjeve të rregullta bazuar në faktorin ndarës të humbjeve;
  - 2.6 Taksa e licencave (Neni 14), që do të bartet në mënyrë të plotë gjatë përshtatjeve të rregullta; dhe
  - 2.7 Kostot e shërbimeve publike, që nuk mbulohen nga ndonjë mekanizëm tjetër.
- 3 Gjatë përcaktimit të kostove të lejuara, rregullatori do t'u referohet, në mes tjerash, edhe:
  - 3.1 Informatave ekzistuese të periudhave të kaluara për vëllimin, koston dhe kualitetin e shërbimeve të OST/OT-së;
  - 3.2 Parashikimin rreth vëllimit, kostove dhe kualitetit të shërbimeve të OST/OT-së;
  - 3.3 Krahasimet me ndërmarrje të ngjashme në Kosovë dhe shtete të tjera në Evropë, duke marrë parasysh ngjashmëritë në mes të industrisë së energjisë elektrike në ato shtete me atë të Kosovës; dhe
  - 3.4 Krahasimet me kostot e aktiviteteve të ngjashme në Kosovë dhe shtete të tjera në Evropë, duke marrë parasysh ngjashmëritë në mes të industrisë së energjisë elektrike në ato shtete me atë të Kosovës.

- 4 Në rastet kur OST/OT pranon të hyra nga mekanizmi i kompensimit ndërmjet OST-ve në regjion, këto të hyra do të zbriten nga të hyrat e lejuara maksimale.
- 5 Alokimi i kapaciteteve ndërkufitare transmetuese, në bashkëpunim me operatorët e sistemeve të transmetimeve të Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, sipas procedurave të përbashkëta rajonale për kalkulimin dhe alokimin e kapaciteteve, të propozuara nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe të miratuara nga Rregullatori. Këtë të drejtë mund ta transferojë tek ndonjë subjekt tjetër rajonal i themeluar për këtë qëllim;
- 6 Menaxhimi i kongjestionit, për të gjitha transaksionet në interkonektorët me sistemet fqinje, në bazë të rregullave dhe mekanizmave të tregut, të cilët përcaktohen dhe zbatohen së bashku me operatorët e tjerë në tregun rajonalë të energjisë elektrike;

### **Neni 9**

#### **Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes**

- 1 Me dorëzimin e vlerësimit të kostove operative dhe të mirëmbajtjes, të cilat kërkohen të mbulohen me të hyrat e lejuara maksimale për periudhën rregullatore vijuese, OST/OT duhet të kërkojë mbulimin e vetëm të atyre kostove të cilat në mënyrë të arsyeshme mund t'u atribuohen të licencuarve të OST/OT-së.
- 2 Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes do të përfshijnë vetëm komponentët apo elementet e kostove të korporatës (të ndonjë kompanie amë apo kompanie degë) që mund t'u atribuohen në mënyrë të arsyeshme të licencuarve të OST/OT-së, duke përdorur praktika të kontabilitetit.
- 3 Në çdo përshtatje rregullative, faktori i efikasitetit dhe faktori ndarës i kursimeve do të aplikohet te kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes, sipas formulës së dhënë në Shtojcën 1.
- 4 Rregullatori do të përcaktojë faktorin e efikasitetit në shqyrtimet periodike, bazuar në përmirësimin vjetor të efikasitetit në kostot operative dhe të mirëmbajtjes të OST/OT-së që mund të priten.
- 5 Gjatë caktimit të faktorit të efikasitetit, rregullatori do t'i referohet, por nuk është i kufizuar apo i limituar, nga faktorët e specifikuar në paragrafin 3 të Nenit 9.

### **Neni 10**

#### **Zhvlerësimi i lejuar**

- 1 Kostoja e zhvlerësimit do të llogaritet në mënyrë lineare si funksion i jetëgjatësisë ekonomike apo teknike dhe bazës së aseteve të rregulluara për kategori të ndryshme të aseteve, siç përshkruhet në Shtojcën 3.
- 2 OST/OT-së nuk do ti lejohet të mbulojë kostot e zhvlerësimit për asetet e financuara nga grantet kapitale dhe kontributet e konsumatorëve (përveç aseteve të përfshira në Bazën e Aseteve të Rregulluara në vitin 2012 dhe ato të përfshira në shqyrimin periodik 2013-2017).

## **Neni 11**

### **Kthimi i lejuar në kapital**

- 1 Kthimi i lejuar në kostot e kapitalit do të llogaritet si funksion i bazës së aseteve të rregulluara dhe mesatares së ponderuar të kostos së kapitalit, siç përshkruhet në Shtojcën 3 dhe në Shtojcën 4.
- 2 Kthimi i lejuar në kapital do të llogaritet bazuar në vlerën e bazës së aseteve të rregulluara në çdo vitë relevant (si mesatare e vlerave fillestare dhe përfundimtare të bazës së aseteve të rregulluara).
- 3 OST/OT nuk do të fitojë kthim të lejuar për asetet e financuara nga grantet kapitale dhe kontributet e konsumatorëve.

## **Neni 12**

### **Kostot e lejuara për shërbime ndihmëse**

- 1 Kostot e lejuara të shërbimeve ndihmëse dhe balancuese për vitin e ardhshëm relevant do të propozohen nga OST/OT gjatë shqyrtimeve periodike dhe gjatë përshtatjeve të rregullta duke përdorur parashikimin për blerjet e nevojshme të shërbimeve OST në vitin e ardhshëm relevant dhe çmimet e parashikuara për këto blerje.
- 2 Parashikimi i këtyre blerjeve të nevojshme dhe çmimeve do të mbështetet me dëshmitë e nevojshme, duke përfshirë këtu edhe marrëveshjet e dakorduara për shërbime ndihmëse të nga OST.
- 3 Rregullatori do të përcaktojë kostot e lejuara për shërbimet ndihmëse, duke marrë parasysh propozimin e lartpërmendur, pas vlerësimit të dëshmive të ofruara për nevojën dhe koston e këtyre shërbimeve. Gjatë këtij vlerësimi, ZRRE do të shqyrtojë nëse këto shërbime ndihmëse i janë nënshtruar prokurimit konkurrues apo do të marrë parasysh ndonjë dëshmi tjetër që mund të sigurohet për të treguar se prokurimi i këtyre shërbimeve është bërë mbi bazë ekonomike.

## **Neni 13**

### **Kostot e lejuara të humbjeve**

- 1 Kostoja e lejuar e humbjeve do të jetë kostoja e parashikuar e humbjeve që do të mbulohet nga OST-ja për të kompensuar humbjet në sistemin e transmetimit, dhe do të llogaritet duke përdorur nivelin e lejuara të humbjeve që do të caktohet gjatë shqyrtimeve periodike.
- 2 Operatori i Sistemit të Transmetimit është pjesëmarrës në treg vetëm për blerje të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin transmetues, si dhe blerjen dhe shitjen e energjisë së balancimit.
- 3 Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të sigurojë energjinë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, balancimin e sistemit dhe shërbimet ndihmëse në rrjetin e transmetimit, sipas parimeve të tregut të energjisë elektrike, transparencës dhe jodiskriminimit;

- 4 Të hyrat e lejuara maksimale do të përshtaten për të reflektuar ndryshimet në koston e lejuar të humbjeve gjatë përshtatjeve të rregullta sipas formulave të dhëna në Shtojcën 1. Kjo përshtatje do të:
  - 4.1 Kthejë nën-mbulimin apo mbi-mbulimin e kostove të lejuara të humbjeve gjatë vitit relevant, duke marrë parasysh nivelin e lejuar të humbjeve, vëllimin e realizuar të hyrjes së energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit sipas çmimit aktual të arsyeshëm, siç përcaktohet nga tregu konkurrues për blerjen e humbjeve;
  - 4.2 Ndajë ndryshimin në mes të kostove të lejuara të humbjeve dhe kostove të realizuara të humbjeve gjatë një viti relevant, bazuar në faktorin ndarës të humbjeve, që caktohet në shqyrtimet periodike; dhe
  - 4.3 Azhurnojë koston e parashikuar të lejuar të humbjeve për vitin e ardhshëm relevant, bazuar në parashikimin e kostove sipas çmimit referent në tregun e energjisë elektrike që përdoret për kalkulimin e koston të humbjeve.
- 5 Gjatë përcaktimit të nivelit të lejuar të humbjeve, rregullatori do të marrë parasysh:
  - 5.1 analizen e humbjeve në rrjetin e transmetimit në baza vjetore, duke përfshirë vlerësimin e humbjeve teknike dhe konsumin e paautorizuar të energjisë elektrike dhe zhvillimin në zbatimin e masave për reduktimin e humbjeve;
  - 5.2 përgatitja brenda vitit aktual, e planit vjetor të humbjeve të transmetimit për vitin vijues dhe dorëzimi për miratim të Rregullatori. Plani vjetor i humbjeve përfshin vlerësimin e humbjeve teknike dhe konsumin e paautorizuar të energjisë elektrike;
  - 5.3 Uljet e pritshme të humbjeve gjatë periudhës rregullative që mund të ndodhin si pasojë e planit të aprovuar të investimit; dhe
  - 5.4 Nivelin e humbjeve të transmetimit në sistemet e krahasueshme të transmetimit në shtete të tjera në Evropë, duke marrë parasysh ngjashmëritë në mes të industrisë së energjisë elektrike në ato shtete me atë të Kosovës.
- 6 Niveli i lejuar i humbjeve dhe faktori ndarës i humbjeve duhet të jetë i mjaftueshëm që të nxisë OST-në të reduktojë humbjet në transmision, por të mos vendosë kosto të atilla për OST-në që do të kërcënonin pozitën e saj financiare.
- 7 Faktori i ndarjes së humbjeve në normë përqindjeje përcakton se çfarë pjese të tepicës ose mungesës së humbjeve të lejuara mbahet nga OST.
- 8 Metodologjia e përdorur për matjen e nivelit të realizuar të humbjeve në transmision mund të ndryshohet në bazë të një pajtimi të përbashkët në mes të rregullatorit dhe OST-së. Në këto raste, niveli i humbjeve të lejuara do të përshtatet në mënyrë që të jetë në përputhje me metodologjinë e ndryshuar, ashtu që niveli absolut i reduktimit të humbjeve (i shprehur në pikë përqindjeje) gjatë periudhës rregullative të mbetet i pandryshuar.
- 9 Humbjet në veri të Kosovës, do të inkorporohen në tarifën e Transmetimit, për një kohë derisa të hiqen barrierat politike.



#### **Neni 14**

##### **Kostot e taksës së licencës**

Rregullatori lejon që OST/OT të mbulojë kosto e licensimit.

#### **Neni 15**

##### **Kostot e përjashtuara**

- 1 Të hyrat e lejuara maksimale nuk do të mbulojnë kostot e ofrimit të shërbimeve (duke përfshirë sigurimin e linjave elektrike apo stabilimentit elektrik) të cilat konsiderohen si shërbime të përjashtuara sipas Shtojcës 5, duke përfshirë:
  - 1.1 Shërbime nga të cilat përfiton në mënyrë të veçantë ndonjë palë e tretë që e kërkon shërbimin; dhe
  - 1.2 Rastet kur shërbimi paguhet nga taskat apo tarifat të tjera që nuk përfshijnë tarifat për përdorimin e sistemit të transmetimit.
- 2 Kostoja e kryerjes së shërbimeve të përjashtuara do të mbulohet nga OST/OT në pajtim me Shtojcën 5.
- 3 Në rastin kur Rregullatori vlerëson se OST/OT nuk mund të bëjë parashikimin e kostove të përjashtuara për shërbimet e përjashtuara gjatë shqyrtimit tarifor, atëherë rregullatori do të kërkojë nga OST/OT të hyrat e realizuara nga ofrimi i shërbimeve të përjashtuara dhe ato do të zbriten gjatë përcaktimit të të hyrave për OST/OT -në në vitin vijues.

#### **Neni 16**

##### **Zbutja e të hyrave të lejuara**

- 1 Gjatë shqyrtimeve periodike, rregullatori mund të zbusë kostot e zhvlerësimit të lejuar dhe kthimit të lejuar në kapital, kostove të operimit dhe të mirëmbajtjes në atë mënyrë që ato të jenë konstante në çdo vit relevant të periudhës rregullative. Kjo zbutje do të arrihet duke u siguruar që vlera neto e tanishme e këtyre kostove të zbutur dhe atij të pazbutur (gjatë periudhës rregullative) të jenë të barabarta, duke përdorur mesataren e kostos së ponderuar të kapitalit si normë diskontimi.
- 2 Gjatë shqyrtimeve periodike, rregullatori gjithashtu mund të përshtatë profilin e të hyrave të lejuara maksimale gjatë periudhës rregullative, në mënyrë që të minimizojë ndryshime të konsiderueshme të menjëhershme në mes të vitit të fundit të periudhës së tanishme rregullative dhe vitit të parë të periudhës së ardhshme rregullative. Rregullatori do t'i kushtojë vëmendje të veçantë ndikimit të çfarëdo profilizimi do të ketë mbi rrjedhën e parasë së OST/OT-së dhe aftësisë së saj që të ofrojë shërbime të rrjetit të sistemit dhe shërbime të operatorit të tregut.

Profilizim shtesë do të bëhet duke aplikuar faktorin profilizues, i cili mund të variojë në çdo vit relevant të periudhës rregullative. Me caktimin e faktorit profilizues gjatë shqyrtimeve periodike,

rregullatori do të sigurohet që vlera neto e tanishme e të hyrave të lejuara maksimale të parashikuara (gjatë periudhës rregullative) të mbetet e pandryshuar, duke përdorur mesataren e kostos së ponderuar të kapitalit si normë diskontimi.

## **KREU IV            TARIFAT PËR SHFRYTËZIM TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT**

### **(TARIFAT E SHST)**

#### **Neni 17**

##### **Parimet e përgjithshme**

- 1    OST/OT do të propozojë tarifatat e SHST për aprovim nga rregullatori në mënyrë që:
  - 1.1    OST/OT-ja të mbulojë të hyrat e lejuara që nuk mbulohen nga tarifatat tjera; dhe
  - 1.2    Tarifatat e SHST të jenë në pajtim me metodologjinë e përpiluar nga OST/OT dhe të aprovuar nga rregullatori. Metodologjia duhet të jetë në pajtim me Parimet e përcaktimit të tarifave për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit dhe taksave për kyçje të nxjerra nga rregullatori.

#### **Neni 18**

##### **Procedura për aprovimin e tarifave për SHST**

- 1    OST/OT do t'i dorëzojë për aprovim rregullatorit metodologjinë për tarifatat e SHST për amendamentimet pasuese së paku 15 ditë pune datës së propozuar të hyrjes së tyre në fuqi.
- 2    Metodologjia apo amendamenti i metodologjisë nuk do të hyjë në fuqi derisa të aprovohet nga rregullatori.
- 3    OST/OT ka të drejtë të propozojë tarifatat SHST sipas kërkesave të Nenit 17.

## **KREU V            TARIFAT PËR OPERATOR TË SISTEMIT**

### **(TARIFAT OS)**

#### **Neni 19**

##### **Parimet e përgjithshme**

- 1 OST/OT-ja do të propozojë tarifat për operatorin e sistemit për aprovim nga rregullatori, në mënyrë që:
  - 1.1 OST/OT të mbulojë kostot e operatorit të sistemit për kryerjen e shërbimeve të operatorit të sistemit, siç autorizohet me licencën e OST-së;
  - 1.2 Kostot e lejuara për humbje të përfshihen në kostot e operatorit të sistemit dhe të mbulohen nga kostot e operatorit të sistemit; dhe
  - 1.3 Tarifat për operator të sistemit të jenë në pajtim me metodologjinë e përpiluar nga OST/OT dhe të aprovuar nga rregullatori. Metodologjia çartëson se si do të alokohen kostot në funksionin e operatorit të sistemit dhe si do të mbulohen këto kosto nga tarifat. Metodologjia duhet të jetë në pajtim me Parimet e përcaktimit të tarifave për shfrytëzimin e sistemi t të transmetimit dhe taksave për kyçje të nxjerra nga rregullatori.

#### **Neni 20**

##### **Procedura për aprovimin e tarifave për operatorin e sistemit**

- 1 OST/OT do t'i dorëzojë për aprovim rregullatorit metodologjinë për tarifat e operatorit të sistemit dhe amendamentimet pasuese së paku 15 ditë pune para datës së saj të propozuar për hyrje në fuqi.
- 2 Metodologjia apo amendamenti i metodologjisë nuk do të jetë efektive derisa të aprovohet nga rregullatori.
- 3 OST/OT ka të drejtë të propozojë tarifat për operatorin e sistemit sipas kërkesave të Nenit 19.

## **KREU VI      TARIFAT PËR OPERATOR TË TREGUT**

### **(TARIFAT OT)**

#### **Neni 21**

##### **Parimet e përgjithshme**

- 1      OST/OT-ja do të propozojë tarifatat për operatorin e tregut për aprovim nga rregullatori, në mënyrë që:
  - 1.1      OST/OT të mbulojë kostot e operatorit të tregut për kryerjen e shërbimeve siç autorizohet me licencën e operatorit të tregut; dhe
  - 1.2      Tarifatat për operatorin e tregut të jenë në pajtim me metodologjinë e përpiluar nga OST/OT dhe të aprovuar nga rregullatori. Metodologjia duhet të theksojë se si do të alokohen kostot në funksionin e operatorit të tregut dhe si do të mbulohen këto kosto nga tarifatat. Metodologjia duhet të jetë në pajtim me Parimet e përcaktimit të tarifave për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit të nxjerra nga rregullatori.

#### **Neni 22**

##### **Procedura për aprovimin e tarifave për operatorin e tregut**

- 1      OST/OT do t'i dorëzojë për aprovim rregullatorit metodologjinë për tarifatat për operatorin e tregut dhe amendamentimet pasuese së paku 15 ditë pune para datës së propozuar të hyrjes në fuqi.
- 2      Asnjë metodologji apo amendamentim i metodologjisë nuk do të jetë efektive derisa të aprovohet nga rregullatori.
- 3      OST/OT ka të drejtë të propozojë tarifatat për operatorin e tregut sipas kërkesave të Nenit 21.

#### **Neni 23**

##### **Tarifa për fondin e energjisë së ripërtitshme**

- 1      Tarifa për fondin e energjisë së ripërtitshme, do të mbulohet nga furnizuesit në mënyrë proporcionale të pjesëmarrjes në tregun e energjisë elektrike.

## KREU VII TAKSAT PËR KYÇJE

### Neni 24

#### Parimet e përgjithshme

- 1 OST/OT-ja do të propozojë taksat për kyçje për aprovim nga rregullatori, në mënyrë që:
  - 1.1 OST/OT të mbulojë kostot e kyçjeve që nuk mbulohen nga tarifat e tjera; dhe
  - 1.2 Taksat për kyçje të jenë në pajtim me metodologjinë e përpiluar nga OST/OT dhe të aprovuar nga rregullatori. Metodologjia duhet të jetë në pajtim me parimet e taksave për kyçje në sistemin e transmetimit të nxjerra nga rregullatori.
- 2 Kostot e kyçjes do të përfshijnë:
  - 2.1 Koston e punëve që kanë të bëjnë me instalimin e stabilimenteve elektrike, linjave, matësve, si dhe pajisjeve të tjera që shfrytëzohen për ndërtimin apo modifikimin e një kyçjeje të ndonjë pike të kyçjes apo konsumatori përderisa këto kosto nuk mbulohen nga tarifat OST/OT-së;
  - 2.2 Koston e mënjanimet të stabilimenteve elektrike, linjave, matësve apo pajisjeve të tjera për shkyçjen e ndonjë pike të energjisë elektrike apo konsumatori nga sistemi i transmetimit që përndryshe nuk mbulohen nga tarifat e OST/OT-së;
  - 2.3 Normën e arsyeshme të kthimit të kapitalit që përfaqësohet nga këto kosto, që përndryshe nuk mbulohen nga tarifat e OST/OT-së; dhe
  - 2.4 Koston e mirëmbajtjes së stabilimenteve elektrike, linjave, matësve dhe pajisjeve të tjera që përndryshe nuk mbulohen nga tarifat OST/OT-së.
- 3 Të hyrat nga taksat për kyçje përfshihen në të hyrat nga shërbimet e përjashtuara siç përkufizohen në Shtojcën 5.
- 4 Kufiri në mes të atyre kostove që mbulohen nga taksat e kyçjes, kostove që mbulohen nga tarifat e OST/OT-së, dhe kostove që mbulohen nga tarifat për operator të sistemit dhe kostove që do të mbulohen nga tarifat për operator të tregut ose nga tarifat e tjera do të definohet në metodologjinë për përcaktimin e taksave të kyçjes.

### Neni 25

#### Procedura për aprovimin e taksave për kyçje

- 1 OST/OT-ja do t'i dorëzojë për aprovim rregullatorit metodologjinë për taksat e kyçjes dhe amendamentimet pasuese së paku 15 ditë pune para datës së propozuar të hyrjes në fuqi.
- 2 Metodologjia apo amendamenti i metodologjisë nuk do të jetë efektiv derisa të aprovohet nga rregullatori.

- 3 OST/OT-ja ka të drejtë të propozojë taksat për kyçe për aprovim nga rregullatori sipas kërkesave të Nenit 24.
- 4 Palët të cilat kyçen në sistemin e transmetimit kanë të drejtë të paraqesin ankesë mbi taksat për kyçe te rregullatori, siç përcaktohet në legjislacionin përkatës.

## KREU VIII TARIFAT PËR FONDIN E ENERGJISË SË RIPËRTËRITSHME

### Neni 26

#### Parimet e përgjithshme

- 1 OST/OT do t'i mbulojë tarifat e skemës mbështetëse për energjinë e ripërtëritshme nga shfrytëzuesit e sistemit të transmetimit.
- 2 Skema mbështetëse për energjinë e ripërtëritshme do të shënohet ndaras në faturat që lëshohen nga OST/OT.
- 3 Vlera totale e mbledhur e të hyrave, do të alokohet në llogarinë e fondit për energjinë e ripërtëritshme dhe asnjë pjesë nga ajo shumë e mbledhur nuk mund të mbahet nga OST/OT.

Financimi i Fondit për Energjinë e Ripërtëritshme mundësohet përmes një Tarife për Energjinë e Ripërtëritshme, e aplikuar në nivel të transmetimit për të gjithë furnizuesit e energjisë elektrike në Kosovë, llogaritur sipas formulës në vijim:

$$REC_t = ((FIT_t - RP_t) \cdot Q_t + I_t + MO_t - G_{t-1} + \Delta CF_{t-1}) / NP_t$$

*Ku:*

*RECT* Tarifa për Energjinë e Ripërtëritshme

*FIT<sub>t</sub>* Tarifa Nxitëse e aplikuar për secilën teknologji relevante në vitin *t*

*RP<sub>t</sub>* Çmimi referent për vitin *t*, me të cilin OT u shet Furnizuesve energjinë e prodhuar nga BRE, ekuivalent me çmimin mesatar të tregut siç përcaktohet në baza vjetore nga ZRRE

*Q<sub>t</sub>* Energjia elektrike e parashikuar, dorëzuar nga secila teknologji relevante në vitin *t*

*I<sub>t</sub>* Kosto e parashikuar e imbalancit, e lejuar nga ZRRE në vitin *t*

*ΔCF<sub>t-1</sub>* Faktori korrektues ndërmjet vlerave të lejuara dhe atyre ekzistuese në vitin *t*

*NP<sub>t</sub>* Shuma e Neto-konsumit të furnizuesve të parashikuar të energjisë në vitin relevant *t*

*MO<sub>t</sub>* Kostoja e parashikuar e shkaktuar nga OT për menaxhimin dhe operimin e Fondit në vitin *t*, duke përfshirë kostot e kapitalit punues dhe çdo kosto tjetër të veprimit të vendosur në mënyrë retroaktive.

*t* Viti relevant



## **KAPITULLI IX DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 27 Interpretimi**

Në rast se ka paqartësi për dispozitat e kësaj rregulle, Bordi do të nxjerrë informacione shpjeguese.

### **Neni 28 Ndryshimi**

- 1 ZRRE mban të drejtën që ta ndryshojë ose ta modifikojë çdo dispozitë të kësaj rregulle.
- 2 Procedurat për ndryshim ose modifikim të kësaj rregulle do të jenë të njëjta si për miratimin e saj.

### **Neni 29 Shfuqizimi**

Kjo rregull shfuqizon rregullën e mëparshme të titulluar: "Rregulla për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të transmisionit dhe tregut" (15 dhjetor 2011) e nxjerrë sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185.

### **Neni 30 Hyrja në fuqi**

Kjo rregull hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen zyrtare elektronike të Rregullatorit.

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji :**

---

Krenar Bujupi, u.d. kryesues

---

Arsim Janova, anëtar

---

Besim Sejfiqaj, anëtar

## SHTOJCA 1 LLOGARITJA E TË HYRAVE TË LEJUARA MAKSIMALE

- 1 Kjo shtojcë paraqet formulat për llogaritjen e të hyrave të lejuara maksimale për OST/OT-në, plotëson dhe sqaron aplikimin e parimeve të dhëna në pjesën kryesore të rregullës.
- 2 Të hyrat e lejuara maksimale (MAR<sub>t</sub>) do të llogariten gjatë shqyrtimeve periodike dhe përshtatjeve të rregullta sipas formulës në vijim:

$$MAR_t = OPMC_t + DEPC_t + RTNC_t + ASVC_t + LSSC_t + LICC_t - ITCR_t - NTFR_t + ADJ_t + KREV_t$$

*Ku janë:*

<i>MAR<sub>t</sub></i>	<i>Të hyrat e lejuara maksimale në vitin relevant t ("Maximum Allowed Revenues in Relevant Year t")</i>
<i>OPMC<sub>t</sub></i>	<i>Kostot operative dhe të mirëmbajtjes në vitin relevant t ("is allowed operating and maintenance costs in Relevant Year t")</i>
<i>DEPC<sub>t</sub></i>	<i>Zhvlerësimi i lejuar në vitin relevant t ("is allowed depreciation in Relevant Year t")</i>
<i>RTNC<sub>t</sub></i>	<i>Kthimi i kostos së kapitalit i lejuar në vitin relevant t ("is allowed return on capital in Relevant Year t")</i>
<i>ASVC<sub>t</sub></i>	<i>Kostot e lejuara për shërbime ndihmëse në vitin relevant t ("is allowed cost of ancillary services in Relevant Year t")</i>
<i>LSSC<sub>t</sub></i>	<i>Kostoja e lejuar e humbjeve në vitin relevant t ("is allowed cost of losses in Relevant Year t")</i>
<i>LICC<sub>t</sub></i>	<i>Kostoja e taksës për licencë në vitin relevant t ("is the Licence Fee in Relevant Year t")</i>
<i>ITCR<sub>t</sub></i>	<i>Të hyrat neto të OST/OT nga mekanizmi kompensues ndër-OST në vitin relevant t ("is net revenues to the TSO/MO under the Inter-TSO Compensation Mechanism in Relevant Year t")</i>
<i>NTFR<sub>t</sub></i>	<i>Të hyrat jo tarifore në vitin relevant t ("Non-tariff revenues in Relevant Year t")</i>
<i>ADJ<sub>t</sub></i>	<i>Përshtatjet e kostove (Adjustment cost in Relevant Year t)</i>
<i>KREV<sub>t</sub></i>	<i>Faktori korrigjues i të hyrave në vitin relevant t ("is the revenue correction factor in Relevant Year t")</i>
2.1	<i>Kostot e lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes (OPMC<sub>t</sub>) do të llogariten gjatë përshtatjeve të rregullta sipas formulës në vijim:</i>

$$OPMC_t = (OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t))$$

2.1.1 Përshtatjet e kostove të OPEX-it duke aplikuar faktorin ndarës të kursimeve bëhen sipas formulës në vijim:

$$OPMC_{Adj} = (OPMC_{ft-1} - OPMC_{ot-1}) * SHF$$

Ku janë:

$OPMC_t$	Kostot operative dhe të mirëmbajtjes në vitin relevant t (“is allowed operating and maintenance costs in Relevant Year t”)
$OPMC_{t-1}$	Kostot operative dhe të mirëmbajtjes në vitin relevant t-1, përveç në vitin relevant 1, ku do të përdoret një vlerë e përcaktuar nga rregullatori që bazohet nga shqyrtimi më i vonshëm periodik (“is allowed operating and maintenance costs in Relevant Year t-1, except for Relevant Year 1 when a value determined by the Regulator at the most recent Periodic Review shall be used”)
$CPI_{t-1}$	Vlera e realizuar e inflacionit në vitin relevant t-1, matur duke përdorur Indeksine e harmonizuara të çmimeve të konsumit (HICPs) – për të gjitha njësitë në Eurozonë, të publikuar nga Eurostat-i, apo ndonjë vlerësim tjetër i inflacionit që rregullatori e përcakton si masën më të mirë të ndryshimit në kostot e operimit dhe mirëmbajtjes gjatë kohës dhe i cili është lejuar gjatë shqyrtimit periodik (“is the actual value of inflation in Relevant Year t-1”)
$E_t$	Faktori i efikasitetit në vitin relevant t, që caktohet gjatë shqyrtimeve periodike (“is the Efficiency Factor in Relevant Year t, which is set at Periodic Reviews”)
$P_t$	Faktori profilizues në vitin relevant t, që caktohet gjatë shqyrtimeve periodike (“is the Profiling Factor in Relevant Year t, which is set at Periodic Reviews”)
$OPMC_{ft-1}$	Kostot operative dhe të mirëmbajtjes të parashikuara në vitin relevant t-1 (the forecast cost of operating and maintenance cost in Relevant Year t-1)
$OPMC_{ot-1}$	Kostot operative dhe të mirëmbajtjes të realizuara në vitin relevant t-1 (the actual cost of operating and maintenance cost in Relevant Year t-1)
SHF	Faktori ndarës i kursimeve i cili aplikohet për kursimet të cilat tejkalojnë faktorin e efikasitetit (“Sharing factor applicable to the saving that exceeds efficiency factor”)

2.2 Kostot e lejuara të zhvlerësimit (DEPCT) do të llogariten gjatë përshtatjeve të rregullta duke përdorur formulën:

$$DEPCT_t = (DEPCT_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t))$$

2.2.1 Përshtatjet e kostove të zhvlerësimit (DEPCT) duke aplikuar faktorin ndarës të kursimeve bëhen sipas formulës në vijim:

$$DEPC_{adj} = (DEPC_{ft-1} - DEPC_{at-1}) * SHF$$

Ku janë:

$DEPC_t$  Zhvlerësimi i lejuar në vitin relevant t, mund të zbutet (sheshohet) ashtu që të jetë konstant gjatë periudhës rregullative (“is other allowed depreciation in Relevant Year t, which is smoothed such that it is constant over the Regulatory Period”)

$DEPC_{t-1}$  Zhvlerësimi i lejuar në vitin relevant t-1, përveç në vitin relevant 1, ku do të përdoret një vlerë e përcaktuar nga rregullatori që bazohet nga shqyrtimi më i vonshëm periodik dhe që është zbutur ashtu që të jetë konstante gjatë periudhës rregullative (“is allowed depreciation in Relevant Year t-1, except for Relevant Year 1 when a value determined by the Regulator at the most recent Periodic Review shall be used, which is smoothed such that it is constant over the Regulatory Period”)

$CPI_{t-1}$  Vlera e realizuar e inflacionit në vitin relevant t-1, matur duke përdorur Indeksën e harmonizuar të çmimeve të konsumit (HICPs) – për të gjitha njësitë në Eurozonë, të publikuar nga Eurostat-i (“is the actual value of inflation in Relevant Year t-1, measured using the “Harmonised Indices of Consumer Prices (HICPs) – All Items, for the Eurozone” published by Eurostat”)

$P_t$  Faktori profilizues në vitin relevant t, që caktohet gjatë shqyrtimeve periodike (“is the Profiling Factor in Relevant Year t, which is set at Periodic Reviews”)

$DEPC_{adj}$  Përshtatja e kostove të zhvlerësimit (Adjustment of depreciation cost)

$DEPC_{ft-1}$  Zhvlerësimi i parashikuar në vitin relevant t-1 (the forecast of depreciation in Relevant Year t-1)

$DEPC_{at-1}$  Zhvlerësimi i realizuar në vitin relevant t-1 (the actual depreciation in Relevant Year t-1)

$SHF$  Faktori ndarës i kursimeve i cili aplikohet për kursimet të cilat tejkalojnë faktorin e efikasitetit (“Sharing factor applicable to the saving that exceeds efficiency factor”)

2.3 Kostoja e lejuar e kthimit të kapitalit ( $RTNC_t$ ) do të llogaritet gjatë përshtatjeve të rregullta sipas formulës:

$$RTNC_t = (RTNC_t * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t))$$

2.3.1 Përshtatjet e kostove të kthimitit ( $RTNC$ ) duke aplikuar faktorin ndarës të kthimit bëhen sipas formulës në vijim:

$$RTNC_{adj} = (RTNC_{ft-1} - RTNC_{at-1}) * SHF$$

Ku janë:

$RTNC_t$	<i>Kthimi i lejuar i kapitalit në vitin relevant t, mund të zbutet(sheshohet) ashtu që të jetë konstant gjatë periudhës rregullative (“ is allowed return on capital in Relevant Year t, which is smoothed such that it is constant over the Regulatory Period”)</i>
$RTNC_{t-1}$	<i>Kthimi i lejuar i kapitalit në vitin relevant t-1, përveç në vitin relevant 1, ku do të përdoret një vlerë e përcaktuar nga rregullatori që bazohet nga shqyrtimi më i vonshëm periodik dhe që është zbutur ashtu që të jetë konstant gjatë periudhës rregullative (“is allowed return on capital in Relevant Year t-1, except for Relevant Year 1 when a value determined by the Regulator at the most recent Periodic Review shall be used, which is smoothed such that it is constant over the Regulatory Period”)</i>
$CPI_{t-1}$	<i>Vlera e realizuar e inflacionit në vitin relevant t-1, matur duke përdorur indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumit (HICPs) – për të gjitha njësitë në Eurozonë, të publikuar nga Eurostat-i (“is the actual value of inflation in Relevant Year t-1, measured using the “Harmonised Indices of Consumer Prices (HICPs) – All Items, for the Eurozone” published by Eurostat”)</i>
$P_t$	<i>Faktori profilizues në vitin relevant t, që caktohet gjatë shqyrtimeve periodike (“is the Profiling Factor in Relevant Year t, which is set at Periodic Reviews”)</i>
$RTNC_{adj}$	<i>Përshtatja e kostove të zhvlerësimit( Adjustment of return cost)</i>
$RTNC_{ft-1}$	<i>Kthimi i parashikuar në kapital në vitin relevant t-1 (the forecast of return on capital in Relevant Year t-1)</i>
$RTNC_{at-1}$	<i>Kthimi i realizuar në kapital në vitin relevant t-1 (the actual return on capital in Relevant Year t-1)</i>
$SHF$	<i>Faktori ndarës i kursimeve i cili aplikohet për kursimet të cilat tejkalojnë faktorin e efikasitetit( “Sharing factor applicable to the saving that exceeds efficiency factor”)</i>

2.4 Kostoja e lejuar e humbjeve ( $LSSC_t$ ) do të llogaritet gjatë përshtatjeve të rregullta sipas formulës:

$$LSSC_t = LSSCA_t * REUE_t * RWMP + (LSSCa_{t-1} - LSAC_{ft-1}) * (1 + I_t) + (LSSCa_{t-1} - LSAC_{t-1}) * LSSF_t$$

*Ku:*

$LSSC_t$  *Kostoja e lejuar e humbjeve për vitin relevant t (“is allowed cost of losses in Relevant Year t”)*

$LSSA_t$  *Humbjet e lejuara, që janë paraqitur si përqindje e energjisë që hyn në sistemin e transmetimit në vitin relevant t (“ is the Loss Allowance, which is a percentage of energy entering the Transmission System, in Relevant Year t”)*

$REUE_t$	<i>Njësitë e energjisë (MWh) që hyjnë në sistemin e transmetimit në vitin relevant t ("is the energy units (in MWh) entering the Transmission System in Relevant Year t")</i>
$RWMP$	<i>Çmimi referent i tregut me shumicë per blerjen e energjisë (€/MWh) në vitin relevant t ("the referent wholesale market electricity price (in €/MWh) in Relevant Year t")</i>
$LSSCa_{t-1}$	<i>Koston e realizuar të humbjeve të lejuara në vitin relevant t-1, (llogaritur duke përdorur humbjet e lejuara) ("is the actual allowed cost of losses in Relevant Year t-1 (calculated using the Loss Allowance)")</i>
$LSSCf_{t-1}$	<i>Kostoja e parashikuar e humbjeve në vitin relevant t-1, (llogaritur duke përdorur humbjet e lejuara) ("Is the forecast cost of losses in Relevant Year t-1 (calculated using the Loss Allowance)")</i>
$I_t$	<i>Norma e interesit për vitin relevant t, që llogaritet bazuar në EURIBOR plus S%, ku S paraqet vlerën e përcaktuar nga ZRRE-ja gjatë shqyrtimeveve apo periodike që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për huatë afatshkurta mbi normën e EUROBOR-it ("the interest rate for the Relevant Year t calculated based on EURIBOR plus S%, where S is a value to be determined by the Regulator at regular or Periodic Reviews and which reflects the premium payable by the licensee for short-term loans above the EURIBOR rate")</i>
$LSAC_{t-1}$	<i>Koston e humbjeve të realizuara gjatë blerjes së energjisë si kompensim të energjisë së humbur në rrjetin e transmetimit (nuk llogaritet duke përdorur humbjet e lejuara) në vitin relevant t-1 ("is cost of losses actually incurred by the TSO in purchasing energy as compensation for energy lost on the Transmission System in Relevant Year t-1 (not calculated using the Loss Allowance)")</i>
$LSSF_t$	<i>Faktori i ndarjes së humbjeve në vitin relevant t, që caktohet gjatë shqyrtimeveve periodike ("is the Loss Sharing Factor in Relevant Year t, which is set at Periodic Reviews")</i>

2.5 Faktori i përshtatjes së të hyrave ( $KREV_t$ ) do të llogaritet gjatë përshtatjeve të rregullta duke përdorur formulën në vijim:

$$KREV_t = (AAC_{at-1} - ARR_{t-1}) * (1 + I_t)$$

*Ku janë:*

$AAC_{at-1}$	<i>Kostot e lejuara aktuale për vitin relevant t-1 ("Actual Allowed Cost as determined in Relevant Year t-1")</i>
$ARR_{t-1}$	<i>Paraqet të hyrat e realizuara në vitin relevant t-1 ("is the Actual Regulated Revenues in Relevant Year t-1")</i>

$I_t$

*Norma e interesit për vitin relevant t, që llogaritet bazuar në EURIBOR plus S%, ku S paraqet vlerën e përcaktuar nga ZRRE-ja gjatë shqyrtimeve periodike që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për hua afatshkurtra (“the interest rate for the Relevant Year t calculated based on EURIBOR plus S%, where S is a value to be determined by the Regulator at Periodic Reviews and which reflects the premium payable by the licensee for short-term loans above the EURIBOR rate”)*

## SHTOJCA 2 VLERAT HYRËSE

- 1 Në këtë shtojcë përshkruhen vlerat hyrëse që janë parametrat kryesorë të cilat përdoren për llogaritjen e të hyrave të lejuara maksimale të OST/OT-së.
- 2 Vlerat pasuese specifikohen si vlera fikse të përcaktuara në shqyrtimin periodik, të cilat do të aplikohen gjatë viteve relevante deri në shqyrtimin e vlerave hyrëse.
- 3 Vlerat hyrëse përbëhen nga:
  - 3.1 Jetëgjatësia e aseteve;
  - 3.2 Mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit;
  - 3.3 Niveli i lejuar i humbjeve;
  - 3.4 Faktori i ndarjes së humbjeve;
  - 3.5 Faktori i efikasitetit;
  - 3.6 Faktori ndares i kursimeve i cili aplikohet për kursimet të cilat tejkalojnë faktorin e efikasitetit; dhe
  - 3.7 Ndonjë parametër tjetër hyrës që rregullatori mund ta konsiderojë të nevojshëm.



### SHTOJCA 3 BAZA E ASETEVE TË RREGULLUARA

- 1 Kjo shtojcë përshkruan përcaktimin e bazës së asetëve të rregulluara për qëllime të llogaritjes së zhvlerësimit të lejuar (Neni 10), si dhe kthimit të lejuar në kapital (Neni 11).
- 2 Baza e asetëve të rregulluara do të jetë vlerë rregullative e shumës së asetëve fikse të përdorura dhe të dobishme në ofrimin e shërbimeve të sistemit të transmetimit dhe operatorit të tregut. Baza e asetëve të rregulluara do të ndahet në kategoritë e ndryshme të asetëve.
- 3 Rregullatori ka definuar vlerën fillestare të bazës së rregulluar të asetëve (më 1 prill 2012) para fillimit të periudhës së parë rregullative.
- 4 Baza e asetëve të rregulluara do të azhurnohet në çdo shqyrtim periodik apo gjatë gjatë përshtatjeve të rregullta si më poshtë:
  - 4.1 Kostoja e lejuar e zhvlerësimit gjatë periudhës rregullative të tanishme do të zbritet nga baza e asetëve të rregulluara dhe do të llogaritet në mënyrë lineare duke përdorur jetëgjatësinë ekonomike;
  - 4.2 Shitjet apo tjetërsimet e asetëve gjatë periudhës rregullative do të zbriten nga baza e asetëve të rregulluara bazuar në vlerën e shitjes së tyre;
  - 4.3 Baza e Asetëve të Rregulluara nuk do të përfshijë asetet e financuara nga grantet dhe kontributet e konsumatorëve (përveç asetëve të përfshira në Bazën e Asetëve të Rregulluara në vitin 2012 dhe ato të përfshira në shqyrimin periodik 2013-2017);
  - 4.4 Shpenzimet e lejuara kapitale gjatë periudhës së tanishme rregullative do t'i shtohen bazës së asetëve të rregulluara nga data kur asetë vihet në shërbim dhe në koston e lejuar në planin e aprovuar të investimeve. Interesi gjatë ndërtimit do të kapitalizohet. Gjatë shqyrtimeve periodike i licencuari mund të kërkojë që kostoja e realizuar e investimit dhe jo e lejuara t'i shtohet bazës së rregulluar të asetëve. Rregullatori duhet ta pranojë kërkesën nëse i licencuari mund ta demonstrojë në mënyrë të qartë se ndryshimi në mes të kostove të lejuara dhe të realizuara është si pasojë e faktorëve jashtë kontrollit të të licencuarit dhe që ai i ka bërë përpjekjet më të mëdha për të minimizuar rritjet e kostove. Rregullatori do të marrë parasysh kostot e arsyeshme të dhe krahasimet me kostot e sistemeve të ngjashme krahasuese në shqyrtimet e ardhshme periodike si masë për parashikimin e kostove të investimeve të ardhshme;
  - 4.5 Nëse një projekt kapital i aprovuar në planin e aprovuar të investimit nuk vihet në shërbim gjatë periudhës rregullative në fjalë, kostoja e tij e lejuar nuk i shtohet bazës së asetëve të rregulluara në shqyrtimin pasues periodik dhe të gjitha të hyrat e përfituara nga projekti në periudhën rregullative do të zbriten nga të hyrat në periudhën e ardhshme rregullative;
  - 4.6 Në rastet kur kostoja e mirëmbajtjes është apo ka qenë më herët e përfshirë në shpenzimet e lejuara operative, nuk do të kapitalizohet dhe as nuk do të përfshihet në bazën e asetëve të rregulluara;

- 4.7 Baza e aseteve të rregulluara do të përshtatet për të marrë parasysh inflacionin përgjatë periudhës së mëhershme rregullative, duke përdorur indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumit për të gjitha njësitë në Eurozonë, të publikuar nga Eurostat si masë relevante; dhe
- 4.8 Politikat e zhvlerësimit të përcaktuara nga ZRRE lidhur me jetëgjatësinë e aseteve do të zbatohen në mënyrë të vazhdueshme dhe konsistente dhe nuk duhet të ndryshohet nga i licencuari për qëllime rregullative.
- 5 Jetëgjatësia ekonomike e aseteve për kategori të ndryshme do të përdoret për të llogaritur zhvlerësimin në bazën e aseteve të rregulluara. Jetëgjatësia ekonomike do të përcaktohet gjatë shqyrtimeve periodike ashtu që ajo të reflektojë jetëgjatësinë teknike të aseteve, përveç në rastet kur ekziston arsye e dëshmueshme se përse jetëgjatësia teknike e asetit duhet të jetë e ndryshme nga jetëgjatësia ekonomike e asetit.
- 6 Investimet kapitale të lejuara do të përcaktohen gjatë shqyrtimeve periodike bazuar në planin e aprovuar të investimit për periudhën e ardhshme rregullative. Plani i aprovuar i investimit do të:
- 6.1 Përfshijë projektet kapitale të cilat janë të nevojshme për të ofruar shërbimet e sistemit të transmetimit dhe operatorit të tregut;
- 6.2 Identifikojë çdo projekt kapital të renditur sipas prioritetit;
- 6.3 Tregojë përfitimin nga performanca e rrjetit që pritet të arrijë çdo projekt kapital, duke iu referuar, kudo që është e nevojshme, përmbushjes së ndonjë standardi të caktuar për sigurinë e sistemit të transmetimit, standardeve të sigurisë së operimit apo planifikimit, siç mund të kërkohet nga licenca e OST-së dhe licenca e OT-së;
- 6.4 Ketë parasysh planet tjera të investimit apo zhvillimore të OST/OT-së që janë aprovuar nga rregullatori (dhe çdo ndryshim në mes të këtyre planeve duhet të identifikohet nga OST/OT dhe të sqarohet), duke përfshirë këtu planin e investimit 5-vjeçar të përgatitur nga OST në pajtim me licencën e aprovuar nga Rregullatori; dhe
- 6.5 Zhvillohet duke përdorur analiza të kostos dhe të benefitit të projektit kapital.
- 7 Plani i aprovuar i investimit do të implementohet si më poshtë:
- 7.1 OST/OT do të bëjë përpjekjet e arsyeshme për të siguruar implementimin e planit të aprovuar të investimit sipas orarit të tij të aprovuar;
- 7.2 Nëse OST/OT, dështon në implementimin e projekteve kapitale në pajtim me orarin e dhënë në planin e aprovuar të investimit, atëherë ajo duhet ta njoftojë rregullatorin. OST/OT duhet të japë arsye të detajuara për vonesën si dhe orarin e rishikuar;
- 7.3 OST/OT mund të aplikojë në çdo kohë te rregullatori për të zëvendësuar një projekt kapital në planin e aprovuar të investimit me ndonjë projekt tjetër kapital, në rastet kur mund të dëshmohet se projekti alternativ do të sjellë përfitime të njëjta apo më të mira për konsumatorët se projekti fillestar (duke marrë parasysh rezultatet e pritura dhe

kostot). Nëse rregullatori e aprovon zëvendësimin, projekti alternativ do t'i shtohet bazës së asetëve të rregulluara në shqyrtimin periodik të ardhshëm; dhe

- 7.4 Nëse OST/OT e zëvendëson një projekt kapital në planin e aprovuar të investimit me një projekt alternativ para se të marrë aprovimin e rregullatorit, rregullatori do ta marrë në konsideratë nëse do ta aprovojë ose jo zëvendësimin në shqyrtimin periodik pasues por nuk është i obliguar ta bëjë këtë.

## SHTOJCA 4 MESATARJA E PONDERUAR E KOSTOS SË KAPITALIT

- 1 Mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit do të llogaritet mbi bazë para-tatimore sipas këtyre formulave:

$$WACC = (1 - g) * (rE) / (1 - t) + gi * (rD)$$

*Ku janë:*

WACC	Mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit (“is the Weighted Average Cost of Capital”)
g	Gearing (norma borxh:borxh+ekuitet) (“gearing (debt:debt+equity ratio)”)
rE	Kostoja reale e ekuitetit (shprehur si %) (“real cost of equity (expressed as a %)”)
rD	Kostoja reale e borxhit (shprehur si %) (“real cost debt (expressed as a %)”)
t	Norma e tatimit mbi korporatat në Kosovë (“Kosovo corporate income tax rate”)

- 2 Leverazhi (gearing) do të jetë vlerë e propozuar nga OST/OT dhe e përcaktuar nga rregullatori në mes të 0 dhe 1 dhe përfaqëson pjesëmarrjen e borxhit në financimin e përgjithshëm. Vlera do të përcaktohet duke marrë parasysh në mënyrë të balancuar financimin aktual të OST/OT-së, financimin që pritet të jetë i arritshëm tani dhe në të ardhmen, duke e marrë parasysh përbërjen e financimeve të kompanive të ngjashme ndërkombëtare.
- 3 Kostoja e ekuitetit (rE) do të jetë vlerë e propozuar nga OST/OT dhe e përcaktuar nga rregullatori, duke marrë parasysh ngjashmerinë me kompanitë me fushëveprim të ngjashëm vendor dhe ndërkombëtar si dhe e llogaritur duke përdorur modelin për vënien e çmimeve të asetëve kapitale (CAPM-Capital Asset Pricing Model) me formulën në vijim:

$$rEi = rf + \beta i * ERPm$$

*Ku janë:*

rf	norma pa risk (“risk-free rate”)
ERPm	premia për riskun në ekuitet që i aplikohet tërë tregut (“equity risk premium applicable to the market as a whole”)
$\beta i$	kovarianca në mes të kthimeve të asetit të ekuitetit në fjalë dhe të asetëve të tërë tregut (beta e ekuitetit) (“covariance between the returns on the individual equity asset and those of the market as a whole (the equity beta)”)

- 3.1 Norma pa risk (rf) paraqet koston e borxhit jokoncesionar shtetëror në Kosovë, në terma realë, që do të propozohet nga OST/OT dhe do të caktohet nga rregullatori, duke

përdorur të dhëna nga kostoja e borxhit jokoncesionar shtetëror në Kosovë ose, në rast të mungesës apo pamjaftueshmërisë së kësaj informate, koston e borxhit jokoncesionar shtetëror në shtete të cilat konsiderohen se kanë status të njëjtë kreditor me Kosovën.

- 3.2 Premia e riskut mbi ekuitetin (ERPm) do të propozohet nga OST/OT dhe do të përcaktohet nga rregullatori, duke përdorur të dhëna nga premia e riskut ndërkombëtar mbi ekuitetin.
  - 3.3 Beta ( $\beta$ ) do të propozohet nga OST/OT dhe do të përcaktohet nga rregullatori, duke përdorur të dhëna mbi betat e aplikuara për kompani të krahasueshme ndërkombëtarisht.
- 4 Kostoja e borxhit (rDi) do të jetë mesatarja e normave të interesit për kreditë ekzistuese afatgjata (që kalojnë 1 vit) për OST/OT, shprehur në terma realë dhe ponderuar sipas vlerës në euro të secilës kredi.
- 4.1 OST/OT është e obliguar të prokurojë huatë komerciale (jokoncesionare) përmes procedurave të konkurrencës ose të demonstrojë te rregullatori se norma e interesit për huatë e marra pa prokurim është e barabartë me, ose më e ulët se, normat e interesit në treg në kohën kur është nënshkruar marrëveshja.
  - 4.2 Kur rregullatori konsideron se norma e interesit për një hua të marrë pa prokurim konkurrues e tejkalon normën e interesit të tregut, atëherë ajo hua do të përjashtohet nga llogaritja e koston së borxhit.
  - 4.3 Kur rregullatori konsideron se ka numër të pamjaftueshëm të huave për të arritur në një vlerësim të koston së huamarrjes për OST/OT-në, rregullatori mund të përshtatë koston e borxhit të llogaritur si më lart. Kjo përshtatje do të bazohet në:
    - (i) Vlerësimin e normës së interesit në treg për huatë e bizneseve me madhësi, risk dhe status kreditor të ngjashëm me OST/OT-në.
    - (ii) Vlerësimin e normës së parashikuar të interesit për huatë e ardhshme koncesionare të OST/OT-së.
    - (iii) Vlerësimin e përbërjes së parashikuar të huave komerciale (jokoncesionare) dhe koncesionare në borxhin e OST/OT-së për periudhën e ardhshme rregullative.

## SHTOJCA 5 SHËRBIMET E PËRJASHTUARA

- 1 OST/OT mund të aplikojë një taksë për kryerjen e shërbimeve të përjashtuara, të cilat mund të jenë, (por nuk kufizohen):
  - 1.1 Kryerjen e punëve, kostoja e të cilave do të riimburohet nga një përdorues i sistemit apo ndonjë palë e tretë (duke përfshirë këtu çdo punë përforcuese) për qëllim të kyçjes së një përdoruesi në sistemin e transmetimit (por vetëm deri në atë masë ku shërbimi nuk është marrë parasysh në kuadër të tarifave të tjera të përshkruara në këtë regull);
  - 1.2 Rivendosja e linjave elektrike apo centraleve elektrike (duke përfshirë këtu edhe punët e ndërlidhura me to) në pajtim me obligimet statutores të tjera nga ato që parashihen për OST/OT-në me Ligjin për Energjinë Elektrike, Ligjin për Energjinë apo Ligjin për Rregullatorin e Energjisë;
  - 1.3 Zhvendosjen e linjave elektrike, stabilimenteve elektrike apo pajisjeve matëse që formojnë pjesë të sistemit të transmetimit për të akomoduar zgjatjen, ridizajnimin apo zhvillimin e vendit në të cilin ndodhet aseti në fjalë ose në të cilin aseti është i kyçur, kostoja e të cilit do të bartet nga një përdorues i sistemit apo nga pala që e kërkon zhvendosjen;
  - 1.4 Kryerjen e punëve të linjave elektrike apo stabilimenteve energjetike nëse kërkohet nga një përdorues i sistemit të transmetimit për të ofruar nivel më të lartë sigurie sesa parashihet në Licencën e OST-së (Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmetimit);
  - 1.5 Kryerjen e shërbimeve tjera që nuk paguhet në kuadër të tarifave të tjera në lidhje me shërbimet e përjashtuara; dhe
  - 1.6 Çfarëdo e hyre tjetër e parregulluar (të hyrat nga dhënia me qira e aseteve, të hyrat nga operatorët e ndryshëm ekonomik, shitja e aseteve, shërbimet e ndryshme ndaj konsumatorëve, etj).
- 2 Taksat për këto shërbime të përjashtuara duhet të caktohen në atë nivel që i lejojnë OST/OT-së të mbulojë:
  - 2.1 Kostot e arsyeshme që dalin nga kryerja e shërbimit; dhe
  - 2.2 Normën e arsyeshme të kthimit të kapitalit sipas shpenzimeve të bëra nga OST/OT gjatë periudhës para marrjes së pagesës nga personi për të cilën është duke u kryer shërbimi në fjalë.
- 3 Në rastet kur është e aplikueshme, këto taksa duhet të përcaktohen në pajtim me metodologjinë e aprovuar të taksave për kyçje.

- 4 Me dhënien e ofertës ndaj personit që aplikon për kryerjen e shërbimit të përjashtuar, OST/OT duhet të ofrojë detaje për koston siç mund të kërkojë aplikuesi me qëllim që të pëcaktohet nëse taksa është e arsyeshme.
- 5 Oferta duhet t'i referohet rolit të rregullatorit siç është dhënë në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.
- 6 Pas përfundimit të çdo viti relevant, OST/OT do t'i ofrojë rregullatorit detaje të shërbimeve të ofruara si pjesë e biznesit të transmetimit, të cilat janë trajtuar si shërbime të përjashtuara nga OST/OT-ja gjatë vitit relevant si dhe të deklarojë të hyrat e pranuar nga këto shërbime.
- 7 Në rastet kur rregullatori mendon se, në bazë të parimeve të përcaktuara në paragrafet e mësipërme, ndonjë shërbim i trajtuar nga OST/OT si shërbim i përjashtuar nuk duhet të trajtohet si i tillë, rregullatori duhet të nxjerrë udhëzime në atë drejtim dhe shërbimi në fjalë nuk do të trajtohet më si shërbim i përjashtuar nga data e nxjerrjes së këtyre udhëzimeve apo nga ndonjë datë tjetër që mund të specifikohet në udhëzime.

## SHTOJCA 6 PROCESI I SHQYRTIMIT PERIODIK

- 1 Me qëllim të ngritjes së transparencës, rregullatori do të publikojë në ueb-faqen zyrtare të gjitha dokumentet e dorëzuara, komentet dhe dokumentet e tjera relevante të pranuar nga OST/OT apo palët e tjera të interesit që kanë të bëjnë me shqyrtimin periodik dhe do t'i bëjë publike të gjitha informatat materiale që dorëzohen nga OST/OT, duke përjashtuar këtu informatat që rregullatori i konsideron komercialisht konfidenciale.
- 2 Rregullatori do të iniciojë shqyrtimin periodik jo më vonë se 120 ditë pune para fillimit të periudhës së ardhshme rregullative.
- 3 Orari për procesin e gjithëmbarshtëm të shqyrtimit do të dërgohet të OST/OT-ja gjatë inicimit të procesit të shqyrtimit.
- 4 Rregullatori do të iniciojë shqyrtimin periodik duke njoftuar OST/OT-në lidhur me:
  - 4.1 Të dhënat për vitet aktuale dhe të parashikuara që kërkohen;
  - 4.2 Formatin me anë të të cilit këto të dhëna do të dorëzohen;
  - 4.3 Orarin për dorëzimin e propozimit të OST/OT-së për të hyrat e lejuara maksimale për shqyrtimin e ardhshëm periodik.
- 5 Propozimi i OST/OT-së do të përmbajë informacionin e mëposhtëm dhe do të adresojë çështjet në vijim (pa kufizim):
  - 5.1 Të hyrat aktuale të rregulluara të mbledhura gjatë periudhës së tanishme rregullative (duke përdorur një vlerësim të arsyeshëm për muajt e mbetur kur është e nevojshme);
  - 5.2 Koston e realizuar për ofrimin e shërbimeve të sistemit të transmetimit gjatë periudhës së tanishme rregullative, në linjë me përkufizimin e koston që është përdorur për llogaritjen e të hyrave të lejuara maksimale;
  - 5.3 Raportin e auditorit dhe pasqyrat financiare të audituara për çdo vit fiskal që ka përfunduar në periudhën e tanishme rregullative, kurdo që këto janë në dispozicion, në pajtim me kërkesat e raportimit të dhëna në licencat e OST/OT-së;
  - 5.4 Vlerën e realizuar të kërkesës maksimale në sistemin e transmetimit, volumin e energjisë së bartur dhe numrin e konsumatorëve gjatë periudhës së tanishme rregullative;
  - 5.5 Vlerat e parashikuara të kërkesës maksimale të sistemit të transmetimit, volumin e energjisë së bartur dhe numrin e konsumatorëve për periudhën e ardhshme rregullative;
  - 5.6 Vlerën e realizuar të humbjeve në transmetim gjatë periudhës së tanishme rregullative dhe parashikimin për humbjet në transmetim për periudhën e ardhshme rregullative;



- 5.7 Propozimin për mesataren e ponderuar të kostos së kapitalit që do të aplikohet në parashikimin e të hyrave të lejuara maksimale për periudhën e ardhshme rregullative;
- 5.8 Vlerën e parashikuar të të hyrave të lejuara maksimale, duke raportuar ndaras secilin prej komponentëve të kostos së lejuar për periudhën e ardhshme rregullative;
- 5.9 Çdo studim të OST/OT-së që mund të ketë ndonjë relevancë me çështjet e ngritura në propozimin e OST/OT-së; dhe
- 5.10 Çdo material tjetër që rregullatori konsideron se duhet të përfshihet në propozimin e OST/OT-së në rastet kur rregullatori e ka njoftuar paraprakisht dhe me kohë të mjaftueshme OST/OT-në për afatin e dorëzimit të propozimit të OST/OT-së.
- 6 Gjatë përgatitjes së propozimit të saj, OST/OT do të aplikojë parimet dhe formulat e zbatuar në këtë rregull.
- 7 Në rastin kur OST/OT nuk ka aplikuar parimet dhe formulat sipas kësaj rregulle, OST/OT duhet të deklarojë të gjitha vendet ku nuk i ka aplikuar ato, arsyet për mosaplikimin e tyre, arsyet që përkrahin qasjen alternative dhe vlerësimin e ndikimit nga përdorimi i qasjes alternative
- 8 Ky propozim duhet të përdorë të dhënat më të vonshme në dispozicion për çmimin referent të tregut i cili do të aplikohet për llogaritjen e kostos së humbjeve.
- 9 Pas marrjes së propozimit të OST/OT-së, rregullatori do të vlerësojë saktësinë, ndërlidhjen dhe arsyeshmërinë e saj duke aplikuar metodologjinë e kësaj rregulle, duke përfshirë këtu vlerësimin se a reflektojnë të hyrat e lejuara maksimale kostot e arsyeshme për ofrimin e Shërbimeve të sistemit të transmetimit dhe shërbimeve të operatorit të tregut.
- 10 Rregullatori do të përgatisë një vlerësim të përkohshëm brenda një afati të arsyeshëm kohor (të përcaktuar në pikën 3 të kësaj shtojce), pas shqyrtimit të propozimeve të OST/OT-së dhe pas konsultimit me OST/OT-në. Vlerësimi i Përkohshëm do të paraqesë propozimet e rregullatorit për të hyrat e lejuara maksimale që do të mbulohen nga OST/OT gjatë periudhës rregullative si dhe arsyeshmërinë për këtë propozim. Rregullatori, në përgatitjen e vlerësimit të tij të përkohshëm, mund të ndryshojë, heqë ose zëvendësojë çfarëdo pjese të propozimit të OST/OT-së që e konsideron të përshtatshme, me kusht që ai t'i identifikojë këto ndryshime, heqje apo zëvendësime dhe të sigurojë jansyetimin për to.
- 11 Pas përcaktimit të vlerësimit të përkohshëm, rregullatori do të njoftojë OST/OT-në dhe do të fillojë procesin e konsultimit publik për vlerësimin e tij të përkohshëm në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.
- 12 Pas përfundimit të konsultimit publik brenda një afati të arsyeshëm kohor (të përcaktuar në pikën 3 të kësaj Shtojce) para fillimit të periudhës së ardhshme rregullative, rregullatori do të marrë vendimin final për të hyrat e lejuara maksimale për periudhën e ardhshme rregullative. Vendimi i rregullatorit do të jetë në pajtueshmëri me këtë rregull. Të hyrat e lejuara maksimale, siç jepen në vendimin final të rregullatorit, do të aplikohen nga data e fillimit të periudhës së ardhshme rregullative.

- 13 OST/OT mund të apelojë apo kontestojë cilindo vendim të rregullatorit në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.

## SHTOJCA 7 PROCESI I PËRSHTATJEVE TË RREGULLTA

- 1 OST/OT do të dorëzojë te rregullatori propozimin për të hyrat e lejuara maksimale për vitin e ardhshëm relevant së paku 50 ditë pune para fillimit të vitit të ardhshëm relevant. OST/OT, po ashtu, do të përfshijë në këtë propozim edhe dokumentet relevante dhe evidencën, përfshirë vlerat që kanë të bëjnë me komponentët e formulave të përshtatjeve të rregullta të dhëna në Shtojcën 1, si dhe çdo informatë tjetër të kërkuar nga rregullatori.
- 2 Rregullatori mund të kërkojë nga OST/OT që të japë sqarime shtesë për metodën e llogaritjes së propozimit për të hyrat e lejuara maksimale dhe, në këto raste, OST/OT do të ofrojë, të gjitha informatat dhe shpjegimet sipas afatit kohor që kërkohet nga rregullatori.
- 3 Rregullatori do ta këshillojë OST/OT së paku 40 ditë pune para fillimit të vitit të ardhshëm relevant nëse e aprovon ose jo llogaritjen nga OST/OT të të hyrave maksimale të propozuara.
- 4 Nëse rregullatori e aprovon propozimin për të hyrat e lejuara maksimale, atëherë këto do të jenë të hyrat e lejuara maksimale për vitin e ardhshëm relevant.
- 5 Nëse rregullatori nuk e aprovon propozimin për të hyrat e lejuara maksimale, rregullatori do të japë arsyetim dhe evidencë për këtë, në pajtim me këtë rregull. Të hyrat e lejuara maksimale nuk do të ndryshojnë derisa rregullatori të aprovon një propozim ose të ofrojë llogaritjen e tij të të hyrave të lejuara maksimale.
- 6 Çdo ndryshim në të hyra që mund të rezultojë nga llogaritja e gabuar e të hyrave të lejuara, raportimi i gabuar i të hyrave rregullative të realizuara apo apelimet lidhur me përshtatjen e rregullt, do të mbulohen në vitet relevante pasuese.
- 7 OST/OT do të llogarisë dhe do të publikojë rezultatet rreth tarifave të OST/OT-së, së paku 15 ditë pune para fillimit të vitit të ardhshëm relevant.
- 8 OST/OT mund të apelojë apo kontestojë çdo vendim të rregullatorit në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.

## SHTOJCA 8 PROCESI I SHQYRTIMIT TË JASHTËZAKONSHËM

- 1 Nëse ka ndodhur një ngjarje e jashtëzakonshme, OST/OT mund të kërkojë shqyrtim të jashtëzakonshëm.
- 2 Shqyrtimi i jashtëzakonshëm nuk mund të fillojë brenda gjashtë muajsh të shqyrtimit periodik apo para kompletimit të shqyrtimit të jashtëzakonshëm të mëhershëm.
- 3 Shqyrtimi i jashtëzakonshëm mund të ketë lidhje me më shumë se një ngjarje të jashtëzakonshme. Në këto raste kjo shtojcë adreson ndikimin e përbashkët financiar të këtyre ngjarjeve.
- 4 Brenda 20 ditëve të punës pas kërkesës së OST/OT për shqyrtim të jashtëzakonshëm, OST/OT duhet të dorëzojë raportin për ndikimin financiar që do të përfshijë çështjet në vijim:
  - 4.1 Përshkrimin e ngjarjes së jashtëzakonshme që ka qenë shkak i kërkesës për shqyrtim të jashtëzakonshëm;
  - 4.2 Përmbledhjen e ndikimit të ngjarjes së jashtëzakonshme në biznesin e OST/OT-së;
  - 4.3 Vlerësimin e ndryshimit të kostove të OST/OT-së në çdo vit nga data e ngjarjes së jashtëzakonshme deri në fundin e periudhës rregullative;
  - 4.4 Vlerësimin për ndryshimin në të hyrat e parashikuara që rezultojnë nga ngjarja e jashtëzakonshme në çdo vit nga data e ngjarjes së jashtëzakonshme deri në përfundim të periudhës së tanishme rregullative;
  - 4.5 Llogaritjen për ndikimin financiar të ngjarjes së jashtëzakonshme në çdo vit, e llogaritur si shuma e ndryshimeve në koston dhe të hyrat e OST/OT-së. Të hyrat do të trajtohen si numër pozitiv dhe kostot do të trajtohen si numra negativ; dhe
  - 4.6 Llogaritjen nëse ndikimi financiar pritet të jetë më i lartë se pragu i materialitetit, shumëzuar me të hyrat e OST/OT-së (në vitin para ngjarjes së jashtëzakonshme), shumëzuar me numrin e viteve në mes të datës së ngjarjes së jashtëzakonshme dhe fundit të periudhës rregullative.
- 5 Nëse OST/OT vlerëson se ndikimi financiar është më i lartë se pragu i materialitetit, OST/OT duhet të përfshijë në raportin e ndikimit financiar propozimin për përshtatjen e jashtëzakonshme në të hyrat e lejuara maksimale. Propozimi për përshtatjen e jashtëzakonshme duhet t'u përmbahet kushteve në vijim:
  - 5.1 Përshtatja e jashtëzakonshme duhet të ndryshojë të hyrat e lejuara maksimale në atë mënyrë që vlera neto e tanishme e ndryshimeve të parashikuara të jetë e barabartë me vlerën neto të tanishme të ndikimit financiar të ngjarjes së jashtëzakonshme, duke përdorur mesataren e ponderuar të koston të kapitalit si normë të diskontimit; dhe

- 5.2 Koha dhe struktura e përshtatjes së jashtëzakonshme do të shmangë, kur është e mundur, rritjet e menjëhershme të tarifave për konsumatorët (për shembull duke zbutur ndikimin e përshtatjes së jashtëzakonshme përgjatë disa viteve).
- 6 Rregullatori gjithashtu mund të fillojë shqyrtim të jashtëzakonshëm pa kërkesën e OST/OT-së. Në këto raste, rregullatori do ta njoftojë OST/OT-në dhe do të përfshijë një përshkrim të ngjarjes së jashtëzakonshme si dhe një pëmbledhje të ndikimit të parashikuar. Pastaj, OST/OT do të përgatisë raportin për ndikimin financiar sipas procesit të përshkruar më lart.
- 7 Rregullatori mund të kërkojë sqarime shtesë nga OST/OT për mënyrën si i ka bërë llogaritjet në raportin për ndikimin financiar si dhe në përshtatjen e jashtëzakonshme dhe, në bazë të kësaj kërkesë, OST/OT do t'i dërgojë rregullatorit, brenda një afati sa më të shkurtër kohor, informatat apo shpjegimet e kërkuara.
- 8 Brenda 20 ditëve pas marrjes së raportit për ndikimin financiar, rregullatori do të njoftojë OST/OT-në nëse rregullatori e pranon apo jo propozimin e OST/OT-së për përshtatjen e jashtëzakonshme. Rregullatori do ta aprovojë propozimin nëse propozimi:
- 8.1 I plotëson kushtet e përshkuara më lart;
- 8.2 Është llogaritur në mënyrë të saktë; dhe
- 8.3 Merr parasysh të gjitha informatat materiale në dispozicion gjatë asaj kohe.
- 9 Nëse rregullatori e aprovon propozimin për përshtatjen e jashtëzakonshme, propozimi për të hyrat e lejuara maksimale do të hyjë në fuqi menjëherë.
- 10 Nëse rregullatori nuk e aprovon propozimin për përshtatjen e jashtëzakonshme, rregullatori duhet të ofrojë arsyetimin dhe evidencën për këtë, në pajtim me këtë rregull. Të hyrat e lejuara maksimale nuk do të përshtaten derisa rregullatori të aprovojë një propozim.
- 11 OST/OT-ja mund të apelojë apo kontestojë çdo vendim të rregullatorit në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.

## SHTOJCA 9      NGJARJET E JASHTËZAKONSHME

- 1      Ngjarja e jashtëzakonshme konsiderohet të jetë:
  - 1.1      Çdo ndryshim në shkallën tatimore, e aplikueshme për OST/OT-në e cila nuk mbulohet tërësisht përmes përshtatjeve të rregullta;
  - 1.2      Ngjarjet e forcës madhore siç përkufizohen në Shtojcën 10;
  - 1.3      Ngjarje tjetër që përmbush të gjitha kushtet në vijim:
    - (i)      Nuk ka qenë nën kontrollin e OST/OT-së;
    - (ii)      Nuk do të mbulohet në përshtatjet e rregullta; dhe
    - (iii)      Ndryshon në masë të konsiderueshme të hyrat dhe/ose kostot e OST/OT përgjatë një periudhe 12 mujore, në atë mënyrë që mund të vlerësohet që mund të tejkalohet pragu i materialitetit (i sqaruar në Shtojcën 8)
- 2      Ndodhja e ngjarjes së jashtëzakonshme është e mjaftueshme për të shkaktuar shqyrtimin e jashtëzakonshëm por, siç është sqaruar në Shtojcën 8, ngjarja duhet të kalojë pragun e materialitetit në mënyrë që të përshtaten të hyrat e lejuara maksimale.

## **SHTOJCA 10    NGJARJA E FORCËS MADHORE**

Forcë madhore - është një akt ose ngjarje natyrore apo shoqërore, si tërmetet, rrufetë, ciklonet, përmytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret ose luftërat, konfliktet e armatosura, kryengritjet, veprime terroriste ose ushtarake, të cilat pengojnë të licencuarin të përmbushë detyrimet e tij sipas licencës, si dhe akte apo ngjarje të tjera që janë përtej kontrollit të arsyeshëm dhe që nuk kanë ardhur për faj të të licencuarit dhe i licencuari nuk ka pasur mundësi të shmangë një akt ose ngjarje të tillë nëpërmjet ushtrimit të vullnetit, përpjekjeve, aftësive dhe kujdesit të tij të arsyeshëm.

## **SHTOJCA 11    DISPOZITAT KALIMTARE**

- 1      Humbjet në Veri të Kosovës, do të inkorporohen në tarifat e Transmetimit.
- 2      Humbjet në Veri do të mbulohen nga furnizuesit në mënyrë propcionale të pjesëmarrjes së tyre në tregun e energjisë elektrike permes tarifave për shfrytëzimin e rrjetit të transmetimit.
- 3      Kushtet e paragrafit 1 të këtij neni do të jetë e aplikueshme për një kohë derisa të hiqen barrierat politike.